



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE INTEGRIMIT EVROPIAN

Nr. 1976/1 Prot.

Tiranë, më 30.1.2018

Lënda: Dërgohet për njohje dhe zbatim

Drejtuar: Të Gjitha Degëve Doganore
Të gjitha Departamenteve
Të gjitha Drejtorive në DPD
Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm

Bashkëngjitur po ju dërgoj shkresën Nr.12942/1Prot., datë 24.01.2018 (Nr.1976Prot DPD, datë 25.01.2018) të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përmes së cilës dërgohet miratimi i "Strategjisë së Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare 2018-2021".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Me respekt,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Belinda IKONOMI





Draft

Strategjia e Biznesit e
Administratës Doganore

Shqiptare

2018-2021

Date: Janar 2018

Version 1.0

1. Hyrje

Rritja ekonomike, globalizimi dhe ndryshimi i shpejtë i mjedisit teknik do të sjellë gjithashtu sfida të reja për Administratën Doganore Shqiptare (ADSH). Doganat si kontribues thelbësor për buxhetin e vendit duhet të jenë të përgatitura ndaj zhvillimeve të reja dhe të kontribuojnë në klimën e biznesit në Shqipëri. Për të ndjekur shtegun e modernizimit, harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe implementimin e praktikave më të mira do të garantohet që do të jetë një nga administratat më të mira në rajon. Niveli i lartë i arsimimit, tërheqja ndaj punës në doganë dhe mosha mesatare e re do të kontribuojnë për këto ndryshime. Kjo strategji siguron parimet kryesore, prioritetet e zhvillimit dhe orientimet e ADSH deri më 2021.

Shërbimi i Parë Doganor në Shqipëri është themeluar në 1912. Administrata doganore është një institucion i pavarur brenda Ministrisë së Financave. Selia e saj qendrore ndodhet në "Rrugën e Durrësit" në Tiranë. Detyrat dhe organizimi i saj rregullohen nga Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.

Gjatë periudhës kohore janar - Dhjetor 2017, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka mbledhur për buxhetin e shtetit 159 miliardë LEK nga 148.8 miliardë LEK në 2016 ose rreth 10.2 miliardë LEK më shumë.


Në 1 janar 2017, ADSH ka 1.102 punonjës. Moshja mesatare e punonjësve është 40 vjeç dhe më shumë se 90% e stafit është e pajisur me diplomë universitare. Raporti midis meshkujve dhe femrave është 28 % femra dhe 72 % meshkuj.

Organizimi i ADSH përbëhet nga 17 degë doganore dhe 15 zyra. Degët doganore ndodhen në: Kukës, Shkodër, Bllatë, Lezhë, Durrës, Tirana, Elbasan, Berat, Fier, Vlorë, Saranda, Kakavija, Tre Urat, Kapshticë, Qafë-Thanë, Korçë dhe Rinas.

Organizimi rajonal i ADSH



Organigrama e Selisë Qendrore të Administratës Doganore Shqiptare



Zyrat Qendrore të ADSH përbëhen nga Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm dhe katër departamente: Departamenti Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore, Departamenti i Analizave dhe Aposteriorit, Departamenti Operativo-Hetimor dhe Departamenti Administrativ.

2. Dokumente të mëparshme dhe Procesi i Zhvillimit dhe Implementimit të Strategjisë

Dokumentet e mëposhtme u morën në konsideratë për hartimin e kësaj Strategjie:

- Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020¹
- Strategjia e Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare²
- Strategjia e Teknologjisë së Informacionit të ADSH³
- Strategjia Ndër-Sektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe-terrorizmit 2013 -2020⁴
- Strategjia mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve⁵
- Strategjia Kombëtare kundër kultivimit dhe tregimit të kanabis⁶
- Strategjia Ndër-Sektoriale kundër Korrupsionit për periudhën kohore 2015 - 2020⁷
- Strategjia Kombëtare mbi Menaxhimin e Mbetjeve dhe Planit Kombëtar mbi Menaxhimin e Mbetjeve⁸
- Planit Kombëtar për Integrimin Europian 2017- 2020⁹
- Strategjia për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale 2016 - 2020¹⁰

Për zhvillimin e strategjisë dhe procesin e implementimit të saj u hartua përfaqja e mëposhtme:

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 17.12.2014 "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale për Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020".

² Dokumenti nr.10615 Prot., Datë 17.07.2012 i Ministrisë së Financave "Për miratimin e Strategjisë së Biznesit të Drejtorisë Doganore Shqiptare".

³ ⁴ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.663, datë 17.7.2013 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe terrorizmit 2013-2020".

⁵ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.119, datë 5.03.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit".

⁶ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.248, datë 29.03.2017 "Për miratimin e Planit të Veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020".


⁷ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.247, datë 20.03.2015 "Për miratimin e strategjisë Intersektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020".

⁸ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.175, datë 19.01.2011 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve".

⁹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.42, datë 25.01.2017 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Europian 2017 - 2020".

¹⁰ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.527, datë 20.07.2016 "Për miratimin e Strategjisë për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale 2016 - 2020".

Procesi i zhvillimit dhe implementimit të Strategjisë



3. Deklarata e Misionit

Misioni ynë është:

- të mbrojë interesat financiare dhe ekonomike të Shqipërisë;
- të kontribuojë për sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë;
- të lehtësojë tregtinë, të bashkëpunojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjithë aktorët përkatës.

4. Deklarata e Vizionit

Vizioni ynë është:

- të bëhemi institucioni shtetëror më i mirë në lidhje me orientimin e shërbimeve duke përdorur qasje inovative;
- të zhvillohemi më tej dhe të modernizohemi në harmoni me standardet ndërkombëtare, praktikat më të mira në bashkëpunim me të gjithë aktorët tonë;
- të kujdesemi për stafin tonë sepse ata janë kapitali i administratës sonë.

5. Vlerat tona thelbësore janë

- Bashkëpunim
- Eficiency
- Siguri
- Integritet
- Motivim

B E S I M

6. Objektivat Strategjik

6.1. Objektivi Strategjik 1

Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave dhe proceseve për të rritur mbledhjen e detyrimeve *

ADSH do të vazhdojë të përmirësojë procedurat doganore dhe të akcizës në mënyrë që të rritet mbledhja e detyrimeve. Vëmendje e veçantë do të vihet në harmonizimin e mëtejshëm me standardet e BE-së dhe praktikën më të mirë, veçanërisht në implementimin praktik të legjislacionit. Laboratori doganor luan një rol të rëndësishëm në klasifikimin e duhur të mallrave dhe në vijimësi sasinë e drejtë të të ardhurave. Akreditimi dhe sanksionimi i Laboratori Doganor do të arrihet.

Masat kryesore:

- Harmonizim i mëtejshëm me Acquis e BE (dogana, akcizë);
- Zhvillimi i udhëzimeve dhe manualeve;
- Implementimi i një sistemi të vetëm garancie;
- Zhvillimi i një sistemi menaxhimi cilësie për laboratorin doganor;
- Fuqizimi i kontrolleve në sektorin e akcizës;
- Mbështetje aktive për implementimin praktik dhe të përbashkët të legjislacionit;
- Zhvillimi dhe implementimi i strategjisë së aposteriorit dhe auditit;
- Rritje e efikasitetit të pikave të kontrollit kufitar;

*Blueprint-ët doganorë të BE-së:

- Legjislacioni
- Detyrimet doganore
- Kontrolli Kufitar dhe i Brendshëm
- Kontrolli aposterior dhe Auditit
- Blueprint-i i Akcizës (të gjitha 4)

6.2. Objektivi Strategjik 2

Implementimi i shërbimit duke u orientuar ndaj administratës dhe rritja e bashkëpunimit *

ADSH do të vazhdojë dhe të fuqizojë aktivitetet për të lehtësuar tregtinë, të shpejtojë procedurat doganore dhe të ulë kostot për biznesin dhe shërbimet. Përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë do të rriten. Një vëmendje e veçantë do të jepet ndaj lehtësimeve të tregtisë (procedurat e thjeshtuara duke përfshirë OEA, rritja e sistemit të garancive, nënshkrimi i MM). Një bashkëpunim aktiv dhe i ngushtë me administratën tatimore dhe të gjithë partnerët e tjerë duhet të thellohet dhe të zhvillohet mëtej.

Masat kryesore:

- Rritja e implementimit të procedurave të thjeshtuara duke përfshirë konceptin e OEA;
- Zgjerim i bashkëpunimit me agjensitë kombëtare dhe ndërkombëtare, institucionet dhe aktorë të tjerë (p.sh. menaxhim i koordinuar i kulijve);
- Përmirësim i bashkëpunimit dhe shkëmbim i informacionit me administratën tatimore;
- Përmirësim i bashkëpunimit doganë - sektor privat (eliminimi i barrierave administrative);
- Plotësimi i kushteve për t'u bashkuar Konventës së Përbashkët të Tranzitit;
- Implementimi i Marrëveshjes së Lehtësimit të Tregtisë së OBT;
- Fuqizimi i orientimit të shërbimeve dhe administrimi i klientëve (duke përfshirë studime mbi klientët);
- Zhvillim dhe investim për një klimë miqësore ndaj biznesit.

** Blueprint-ët doganorë të BE-së:

- Lehtësimi i Tregtisë
- Tranziti doganor
- Sigurimi i zinxhirit të furnizimit.

6.3. Objektivi Strategjik 3

Kontributi për sigurinë dhe mbrojtjen **

ADSH do të fuqizojë mëtej aktivitetet dhe veprimet që kontribuojnë në sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë, ruajtje më të mirë të shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Një rëndësi e veçantë do t'i vihet luftës kundër shkeljeve ndaj IPR. Një sistem i menaxhimit të riskut gjithëpërfshirës në harmoni me modelet e harmonizuara të menaxhimit të riskut të BE-së duhet të zhvillohet dhe mirëmbahet. Një bashkëpunim aktiv me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes duhet të promovohet dhe të thellohet.

Masat kryesore:

- Zhvillimi i një sistemi të menaxhimit të riskut gjithëpërfshirës
- Rritja e bashkëpunimit me aktorë kombëtar dhe ndërkombëtar
- Prezantimi i masave për të arritur një balancë të duhur ndërmjet kontrollit dhe lehtësimit
- Përmirësimi i fushës së kulizimeve dhe ndalimeve
- Zhvillimi i masave për të luftuar falsifikimin dhe mashtrimin
- Rritja e performancës në fushën e zbatimit të ligjit dhe inteligjencës
- Zhvillimi i masave në fushën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit.

** Blueprint-ët doganorë të BE-së:

- Menaxhimi i riskut
- Hetimi dhe zbatimi i ligjit
- Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale

6.4. Objektivi Strategjik 4

Përmirësimi dhe modernizimi i organizatës **

Mjedisi i doganës po ndryshon shumë shpejt. ADSH do të vazhdojë të ndjekë dhe t'u përgjigjet në mënyrë aktive ndryshimeve që dalin. Duhet të prezantohen ndryshimet e nevojshme organizative duke përfshirë rialokimin e burimeve. Standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira duhet të përdoren për të përmirësuar performancën e organizatës. Plane afat-gjata investimi duhet të zhvillohen dhe implementohen me përdorimin e asistencës financiare ndërkombëtare.

Masat kryesore:

- Implementimi i një strukture organizative fleksibël (rishikim i rregullt i strukturës organizative dhe alokimi i burimeve duke u mbështetur në ngarkesën në punë dhe prioritetet)
- Implementimi i një sistemi së matjes së performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare
- Zhvillimi i planeve afat-gjatë të investimit që do të mundësojë përdorimin efikas të programeve ndërkombëtare, projekteve dhe fondeve për modernizim
- Promovimi i rolit unik të doganave (duke përfshirë deklaratat e misionit dhe vizionit, vlerat thelbësore dhe arritjet) për punonjësit dhe publikun e përgjithshëm
- Zhvillim i mëtejshëm dhe implementim i kanaleve të komunikimit (internet, mediat sociale, newsletters, aplikacione etj.)

** Blueprint-ët doganorë të BE-së:

- Organizimi dhe Menaxhimi
- Infrastruktura dhe Pajisjet
- Laboratori Doganor
- Komunikimi

6.5. Objektivi Strategjik 5

Përmirësimi i profesionalizmit dhe cilësisë së punës së punonjësve **

ADSH do të ndërmarrë në mënyrë aktive aktivitete për të rritur imazhin publik dhe reputacionin e doganave. Me përdorimin e standardeve ndërkombëtare, programe të reja trajnimi do të zhvillohen për të përmirësuar profesionalizmin e punonjësve. Aktivitete dhe veprime në fushën e luftës kundër korrupsionit do të fuqizohen dhe implementohen. Masat e nevojshme që garantojnë një staf të shëndetshëm dhe të motivuar duhet të zhvillohen.

Masat kryesore:

- Zhvillimi dhe implementimi i programeve të trajnimit për të ardhurit rishtas dhe punonjësit (strategji trajnimi)
- Përmirësimi i sistemit të zhvillimit të karrierës profesionale (rishikime vjetore, rotacione, etj.)
- Rritja e komunikimit të brendshëm dhe shkëmbimi i informacionit
- Implementimi i masave në fushën kundër korrupsionit dhe fuqizimi i qasjes ndaj etikës
- Implementimi i një sistemi menaxhimi inovativ
- Zhvillimi i një programi të sigurisë shëndetësore

** Blueprint-ët doganorë të BE-së:

- Etika doganore

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Trajnim
- Auditi i brendshëm

6.6. Objektivi Strategjik 6

Përmirësimi i sistemeve dhe platformave të TI **

Roli i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është për të mbështetur kërkesat e biznesit në shkallën më të gjerë të mundshme për të gjitha fushat e biznesit. Metoda moderne të punës duke përfshirë një mjedis pa letër duhet të implementohen mëtej. Njëra nga sfidat kryesore do të mbesë garantimi i mundësisë së ndërfaqes me sistemet dhe standardet e TI-së së BE-së.

Masat kryesore:

- Zhvillimi, implementimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afat-gjatë të TI-së që mbështet prioritetet e biznesit
- Përmirësimi i organizimit dhe menaxhimit të TI-së
- Përmirësimi i TI-së në të gjithat strukturat e ndryshme hierarkike
- Implementimi i NCTS, ITMS dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së
- Prezantimi i një mjedisi të plotë pa letër

** Blueprint-ët doganorë të BE-së:

- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

7. Faktorët kritikë të suksesit

Për implementimin e suksesshëm të strategjisë së biznesit duhet të respektohen faktorët e mëposhtëm kritikë të suksesit:

- Përkushtim politik dhe i menaxherëve të lartë si dhe ndërgjegjësimi ndaj filozofisë që njerëzit janë “çelësi i suksesit” në arritjen e objektivave të organizatës
- Monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm duke rishikuar në mënyrë të rregullt planin e veprimit
- Disponueshmëria e burimeve adekuate

8. Harta e Strategjisë së Doganave Shqiptare

HARTA E STRATEGJISË SË DOGANAVE SHQIPTARE

Misioni jonë është

- të mbrojë interesat financiare dhe ekonomike të Shqipërisë
- të kontribuojë për sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë
- të lehtësojë tregtinë, të bashkëpunojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjithë aktorët përkatës

Vizioni jonë është

- të bëhemi institucioni shtetëror më i mirë në lidhje me orientimin e shërbimeve duke përdorur qasje inovative
- të zhvillohemi mëtej dhe të modernizohemi në harmoni me standardet ndërkombëtare, praktikuar më të mira në bashkëpunim me të gjithë aktorët tonë
- të kujdesemi për stafin tonë sepse ata janë kapitali i administratës sonë

Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave dhe proceseve për të rritur mbledhjen e detyrimeve

Përmirësimi dhe modernizimi i organizatës

Përmirësimi i profesionalizmit dhe cilësisë së punës së punonjësve



Implementimi i shërbimit duke u orientuar ndaj administratës dhe rritja e bashkëpunimit

Kontributi për sigurinë dhe mbrojtjen

Përmirësimi i sistemeve dhe platformave të TI

